

Një cifël e saj e qëlloi Mihrijen për vdekje. Ajo, në ato çaste, gjendej në ballkonin e shtëpisë. Në të njëjtën mbrëmje, Azizi me ndihmën e bashkëfshatarëve e varrosën Mihrijen në varrezat e Maralisë/Maralija.

Burimet: deklarata A.V, FDH-34648; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31242; UNMIK, ZPZHML, *Certifikata mbi vdekjen*, FDH-36496.

Mirush (Kurtish) Dakaj

(1.1.1962, shqiptar nga Cerroviku/Cerovik, komuna e Klinës/Klina, student, pjesëtar i UÇK-së)

Mirushi u bë anëtar i UÇK-së në fillim të vitit 1998. Në mesin e bashkëlufthetarëve ishte i njohur si Komandant Korbi. Në datën **11.09.1998**, Mirushi, i vëllai Nuredini, Arben Maloku dhe disa ushtarë të tjerë shkuan në shkollën fillore në **Golluboc/Golubovac**, për të ndarë ndihmën për banorët e fshatit. Me këtë rast, forcat serbe hapën zjarr ndaj tyre dhe e plagosën Mirushin për vdekje. Pjesëtarët e UÇK-së e kanë varrosur Mirushin po atë ditë në fshatin Murgë/Murga [Skënderaj/Srbica]. Pas lufte, në muajin tetor të vitit 1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Mirushit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica [Klinë/Klina].

Burimet: deklarata A.D, FDH-31858; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Zoran (Svetomir) Vasiljević

(14.02.1970, serb nga Kragujevci, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Zorani punonte në SPB-në e Kragujevcit. Nga viti 1990, ai shpeshherë shkonte me detyrë në Kosovë. Në mbrëmjen e datës **18.09.1998**, rreth orës 21:00, ai gjendej në mesin e grupit të policëve serb, i cili e shfrytëzonte një shtëpi të boshatisur shqiptare në fshatin **Astrazup/Ostrozub**. E humbi jetën kur ndaj tij aksidentalisht ka shtënë një koleg i tij. Familjarët e kanë varrosur në varrezat Koriqani [Kragujevc] më 20.09.1998.

Burimet: deklarata S.V, FDH-25822; ICTY, IT-05-87 (Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00614,

FDH-35527; SMIP, *Teroristički...*, III, 939; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 18; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Osman (Metë) Paqarizi

(12.05.1930, shqiptar nga Dragobili/Dragobilje, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor ndërtime, shtatë fëmijë)

Fehmi (Miftar) Paqarizi

(25.02.1950, shqiptar nga Dragobili/Dragobilje, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, pesë fëmijë)

Familjet e Osmanit dhe djalit të axhës Fehmiut e braktisën **Dragobilin/Drago-bilje** në fund të verës së vitit 1998 dhe u strehuan në fshatin fqinj të Guriqit/Gorić. Në datën 15.09.1998, u kthyen në fshat. Herët në mëngjes, më **20.09.1998**, Fehmiu dhe Osmani e çuan së bashku bagëtinë në kullotë. Në mbrëmje, bagëtitë u kthyen vet në shtëpi, por Osmani dhe Fehmiu munguan. Familjarët i pritën deri në mëngjesin tjetër. Atëherë, babai i Fehmiut, Miftari, ka shkuar në stacionin policor në Malishevë/Mališevo, për të paraqitur zhdukjen e Osmanit dhe Fehmiut. Policia serbe i ka dhënë leje me shkrim, me të cilën i lejohej shkuarja në pyll [pushteti serb e kishte ndaluar hyrjen e qytetarëve në një pjesë të pyllit], për të kërkuar të vëllain dhe të birin. Me ndihmën e vëllait tjetër Bejtullahut, Miftari i ka gjetur trupat e pjetë të Fehmiut dhe Osmanit në pjesën e pyllit ku ishte ndaluar hyrja e njerëzve. Fehmiu i kishte në gjoks plagët nga plumbat, ndërkaq Osmani e kishte një plagë te goja. Policia i ka çuar trupat e Fehmiut dhe Osmanit në spitalin e Prishtinës/Priština, nga ku familjarët i morën pas dy ditësh. Pjesëtarët e MPB-së nuk u lejuan familjarëve që viktimat t'i varrosnin në Dragobil/Drago-bilje dhe ato u varrosën po atë ditë në varrezat e fshatit fqinj të Maralisë/Maralija.

Burimet: deklarata S.P, FDH-34643; deklarata V.P, FDH-12287; SMIP, *Teroristički...*, III, 490; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; fotografi, FDH-35338.

Lulëzim (Avdyll) Gashi

(3.01.1981, shqiptar nga Vërmica/Vrmnica, komuna e Malishevës/Mališevo)